



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0095268/22-15 dt. 26.10.2022

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 2, paragrafi 5, të Rregullores (MF) Nr. 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve; nenit 13, paragrafi 1, pika 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 3, nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 10.1.10, dhe nenit 18, paragrafi 2, të Rregullores Komunale Nr. 11/2013 Për ndarjen e subvencioneve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 26.10.2022; sjell këtë:

VENDIM

Për mbështetje financiare (subvencionim) të OJQ-së “Bota e Fëmijëve”

1. MIRATOHET Kërkesa Nr. 02-453/01-0093190/22 dt. 11.10.2022 e OJQ-së “Bota e Fëmijëve” - Mitrovicë, për mbështetje financiare.
2. OJQ “Bota e Fëmijëve” - Mitrovicë, mbështetet me mjete financiare prej 1,000.00 (njëmijë) € nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfereve – Zyra e Kuvendit të Komunës.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten në xhirollogarinë e shoqatës së lartpërmendur, pasi shoqata të plotësojë dhe dorëzojë dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1 Projektet ku përshkruhen aktivitetet dhe agjenda e planifikuar me buxhet,
 - 1.2 Certifikata e OJQ-së,
 - 1.3 Fotokopja e kartelës së llogarisë bankare,
 - 1.4 Letërnjoftimi i bartësit të kartelës,
 - 1.5 Shënimet e personit kontaktues përgjegjës, dhe
 - 1.6 Raporti për gjendjen financiare të OJQ-së për dy vitet paraprake.
4. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

